

VENDIM
Nr. 101, datë 24.6.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “SEKË”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 kw DHE “ZAIS”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2295 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 14962 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3, dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 747 prot., datë 5.6.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 8, të kontratës së koncesionit nr. 7030 rep., nr. 2134 kol., datë 12.6.2013, “Kontratë koncesioni e formës BOT (ndërtim, operim, transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “Sekë”, të lidhur midis METE-s (sot MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Hydro-Project” sh.p.k. dhe “Gener 2” sh.p.k. Kjo shoqëri është regjistruar pranë QKB-së në datën 16.9.2013, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE:

- Certifikatë për vërtetim titulli “Në përdorim”, e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Mirditë, në datën 17.7.2017. Në këtë certifikatë janë pasqyruar: Zona kadastrale 3874, nr. pasurie 218, vol. 2, faqe 150, adresa e pasurisë: Zais, Mirditë.

- Kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullësor publik” me nr. 83, prot., datë 10.1.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Mat, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit. Në objektin e saj, kjo kontratë ka dhënie me qira të fondit pyjor/kullësor 11.8321 km, me qëllim hapje kanalesh, shtrirje tubacionesh, ndërtim rruge, linjë tensioni 35 kV, për ndërtimin e impianteve hidroelektrike “Sekë” dhe “Zais” mbi lumin Uraka dhe përroin e Melthit dhe 2.3878 ha sipërfaqe në përdorim, në administrim dhe në pronësi të Bashkisë Mat. Afati i kësaj kontrate është 6-vjeçar, me të drejtë rinovimi, duke filluar nga e nesërmeja e nënshkrimit të saj nga palët.

- Kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të sipërfaqeve fond pyjor dhe kullësor në administrim të Bashkisë Mirditë, në funksion të ndërtimit të HEC-it të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. me nr. 83 prot., datë 10.1.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Mirditë, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit. Në objektin e saj kjo kontratë ka dhënie me qira të sipërfaqes prej 2.03 ha dhe 3.946 km, me qëllim ndërtimin e linjës gjatësore, kanale tubacione, 1.416 km, linja gjatësore, shtrirje linje elektrike të

nëndheshme 2.0704 km, ndërtim rrugë në vendin e quajtur ekonomia pyjore/kullosore Kunor–Valmor në Selitë në administrim të Bashkisë Mirditë për shoqëri “Seka Hydropower” sh.p.k. Afati i kësaj kontrate do të jetë 10-vjeçar, duke filluar nga data 26.2.2018 deri më 25.2.2028, me të drejtë rinovimi, ku secila palë njofton palën tjetër një muaj përpara përfundimit të saj për të negociuar zgjatjen e afatit.

- Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 4899 prot., datë 12.9.2017, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC-et “Sekë” dhe “Zais”, të cilat do të lidhen në rrjetin 110 kV të transmetimit nëpërmjet një trakti transformatori 110 kV në nënstacionin 110/6.3 kV, HEC Prellë. Kjo do të realizohet nëpërmjet lidhjes me sistemin e zbarrave 110 kV në nënstacionin 110/6.3 kV HEC “Prellë” dhe një transformimi 110/35 kV, me fuqi transformatorike 25 mVA, në këtë nënstacion.

- Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. 179 prot., datë 17.9.2018, të miratuar nga KBU Mat, me vendimin nr. 24, datë 12.9.2018, për shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., me qëllim përdorimin e burimit të ujit të Përroit të Melthit, degë e lumit të Urakës, degë e lumit Mat, për HEC-et “Sekë” dhe “Zais”. Periudha e vlefshmërisë së saj është e barabartë me atë të kontratës së koncesionit të formës BOT. Kjo leje është e vlefshme për këtë aplikim.

- Deklaratë mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 6220 prot., datë 19.7.2018, me nr. 533 identifikimi dhe nr. 33 vendimi, për personin juridik “Seka Hydropower” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin, ndërtim i HEC-eve ‘Sekë’ dhe ‘Zais’”. Kjo deklaratë mjedisore është lëshuar për kapacitetin total të instaluar të HEC-eve “Sekë” dhe “Zais”, 14962 kw, me vendndodhje mbi lumin e Urakës dhe përroit të Melthit, Bashkia Mat dhe Mirditë, e cila përkon me kontratën e koncesionit, me kërkesën e shoqërisë dhe me marrëveshjen e lidhjes me rrjetin. Kjo leje konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit apo plotësimin e saktësimin, që ka të bëjë me:

- dokumentet e parashikuara në nenin 9, pika 2, germa “d” (Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë): plotësuar pjesërisht.

- dokumentacioni financiar dhe fiskal.

- dokumentet e parashikuara në nenin 9, pika 3, germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit): plotësuar.

- dokumentacioni i parashikuar në germën “d” (Vërtetimin e pagesës së aplikimit në llogari të ERE-s): plotësuar pjesërisht.

- dokumentacioni i parashikuar në nenin 9, pika 4.1.1 (Të dhëna teknike për HEC-et): plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të bëjë me dije në ERE afatin e jetëgjatësisë së pritshme të centralit,

do të njoftohet shoqëria që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

- Në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti